VENDIM
Nr. 72, datë 15.4.2024

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KATEGORINË E KLIENTËVE "FURRA BUKE DHE/OSE PRODHIM MIELLI"

Në mbështetje të neneve 16, 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; neneve 15, dhe 22 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe "Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.4.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 793/6 prot., datë 12.4.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve 'Furra buke dhe/ose prodhim mielli'",

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 1583 prot., datë 19.3.2024, protokolluar në ERE me nr. 793 prot., datë 20.3.2024, ka përcjellë në ERE kërkesën për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve "Furra buke dhe/ose prodhim mielli", të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

- FSHU sh.a., në kërkesën për përcaktim të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për subjektet "Furra buke dhe/ose prodhim mielli", të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV, ka propozuar një kategorizim të ri të këtyre subjekteve, si më poshtë vijon:

- Kategoria I, ku përfshihen subjektet të cilat përfitojnë çmimin 7.6 lekë/kwh të energjisë elektrike.

Për përfitimin e kësaj tarife subjektet duhet të disponojnë:

1. Licenca për prodhim dhe tregtim buke me NIPT të veçantë të dedikuar ose sekondar.
2. Ambienti i prodhimit ose tregtimit të jetë i veçantë, me dalje më vete dhe i ndarë me ambientet e tjera.
3. Duhet të jenë këto pajisje të domosdoshme:

Dhomë ardhjeje, brumatriçe me kapacitet mbi 50 kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregtimin e bukës.

- Kategoria II, ku përfshihen subjektet të cilat përfitojnë çmimin 9.5 lekë/kwh të energjisë elektrike.

Për përfitimin e kësaj tarife subjektet duhet të disponojnë:

1. Licenca duhet të jetë: prodhim dhe tregtim buke, brumëra dhe pastiçerie.
2. Në ambientet e prodhimit dhe të tregtimit duhet të jenë këto pajisje të domosdoshme: dhomë ardhjeje, brumatriçe me kapacitet mbi 50 kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregtimin e bukës.
3. Në ambientet e saj mund të ketë dhe pajisje të tjera për prodhimin, ruajtjen dhe tregtimin e të gjitha produkteve të veta, të pastiçerisë dhe brumërave, si:

Pajisje frigoriferike pune, ngrirës dhe freskues, mikser, abatitor, sfoliatriçe, pajisje të tjera pastiçerie, banakë (ekspozitor), freskues, ngrirës, ngrohës për tregtimin vetëm të produkteve të veta, të bukës, pastiçerisë dhe brumërave.

- Kategoria III, subjektet të cilat përfitojnë çmimin 12 lekë/kwh të energjisë elektrike.

Për përfitimin e kësaj tarife subjektet duhet të disponojnë:

1. Këtë çmim do ta përfitojnë të gjitha ato subjekte që në ambientet e tyre, prodhohet dhe tregtohet: bukë, pastiçeri dhe prodhime brumërash.

2. Duhet të ketë të instaluar pajisjet përkatëse, si: dhomë ardhjeje, brumatriçe me kapacitet mbi 50 kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregtimin e bukës.

3. Në ambientet e saj mund të ketë dhe pajisje të tjera për prodhimin, ruajtjen dhe tregtimin e të gjitha produkteve të veta, të pastiçerisë dhe brumërave, si: pajisje frigoriferike pune, ngrirës dhe freskues, mikser, abatitor, sfoliatriçe, pajisje të tjera pastiçerie, banakë (ekspozitor), freskues, ngrirës, ngrohës për tregtimin vetëm të produkteve të veta, të bukës, pastiçerisë dhe brumërave.

4. Në këto ambiente mund të përfshihet edhe shërbimi bar-kafe dhe ushqim vetëshërbim.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 49, datë 2.4.2024, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë për kategorinë e klientëve "Furra buke dhe/ose prodhim mielli", të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV.

- Shoqëria FSHU sh.a., në vijim të kërkesës të ERE-s nr. 793/3 prot., datë 4.4.2024, ka përcjellë informacionin në lidhje me efektet e pritshme nga kategorizimi i ri i këtyre subjekte, si dhe ndryshimi i çmimeve për secilën kategori klientësh, duke argumentuar si vijon:

- Të dhëna historike mbi konsumin e energjisë elektrike për kategorinë e klientëve "Furra buke dhe prodhim mielli", për periudhën 2017–2023, sipas raporteve të strukturës së shitjes. Shoqëria deklaron se ndryshimet e pazakonta në trendin e konsumit të energjisë në këtë kategori, lidhen me masat e marra për saktësimin e klasifikimit të këtyre klientëve, me kalime të shumta në kategorinë e klientëve privatë, me çmim energjie prej 14 lekë/kwh. Masat e marra për riklasifikimin e kësaj kategorie, kanë zvogëluar në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, me rreth 18 % konsumin e energjisë elektrike të klientëve "Furra buke/ prodhim mielli".

- Në analizën e kryer nga vetë shoqëria FSHU sh.a. për vitin 2024, nën supozimin se rritja e konsumit të kësaj kategorie klientësh do të vijojë të ruajë trendin e vitit 2023 prej 2.1%.

- FSHU sh.a., me shkresën nr. 1874/1 prot., datë 8.4.2024, protokolluar me tonën me nr. 793/4 prot., datë 9.4.2024, përcolli në ERE informacion në përgjigje të kërkesës së dërguar nga ERE (nr. 793/1 prot., datë 5.4.2024).

- Duke konsideruar kompleksitetin dhe problematikat e shfaqura në procesin e faturimit të energjisë elektrike për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë "Furra buke dhe/ose prodhim mielli", më datë 11.4.2024 u zhvillua një seancë teknike. Palët pjesëmarrëse në këtë seancë ishin shoqëria FSHU sh.a., "Shoqata e prodhuesve të bukës pastiçerisë dhe brumërave", Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si dhe OSHEE Group, të cilat u vunë në dijeni përmes njoftimit me nr. 793/3 prot., datë 5.4.2023, si dhe drejtoritë teknike të ERE-s.

- Gjatë kësaj seance dëgjimore, përfaqësuesit e shoqatës, si dhe shoqërisë FSHU sh.a., parashtruan faktin se qëllimi i këtij propozimi për kategorizimin dhe përcaktimin e çmimit në përmbushje të kërkesave të "Shoqatës së prodhuesve të bukës, Pastiçerisë dhe Brumërave", lidhet në mënyrë direkte me mbrojtjen e konsumatorëve nga mundësitë e rritjes së çmimeve të bukës si një produkt me efekt rrënjësor në koston e jetesës së qytetarëve, si dhe me zvogëlimin e mundësive për diskriminim në aktivitetin e subjekteve të përfshira në këtë kategorizim dhe njëkohësisht me klasifikimin e drejtë të tyre.

- FSHU-ja deklaron se çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike do të jetë 9.5 lekë/kwh, që përkon me propozimin për klientët në aktivitetin "Furra buke", të cilat tregtojnë dhe prodhime brumi (pastiçeri).

- Shoqëria parashikon se rivlerësimi i aktivitetit të këtyre klientëve duke u mbështetur në kushtet e licencimit, si dhe klasifikimi i tyre sipas çmimeve të reja, do të sjellë kthimin e klientëve privatë, që aktualisht blejnë energji elektrike me çmimin 14 lekë/kwh, gjë e cila do të shkaktojë dhe reduktimin e të ardhurave të pritshme të shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2024.

- Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 të nenit 8 të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë, që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)", miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s, i licencuari do të propozojë çmime të reja për çdo kategori klientësh, me qëllim që të mbledhë të ardhurat e kërkuara për secilën nga kategoritë e klientëve.

- FSHU sh.a., gjithashtu, ka përcjellë dhe parashikimin e pasqyrës së performancës për vitin 2023, pasi deklaron se pasqyrat financiare janë ende në proces auditimi, si dhe parashikimin e saj për vitin 2024. Pasqyrat e paraqitura janë sintetike në evidentimin e të dhënave dhe joanalitike, të cilat nuk mundësojnë kryerjen e vlerësimeve të drejta sa i takon mjaftueshmërisë së të ardhurave për arsye se shpenzimet e paraqitura nga shoqëria nuk evidentojnë nën kategoritë e tyre. Evidenca në këtë kontekst nuk mundëson kryerjen e krahasimeve dhe diferencave sa u takon shpenzimeve/të ardhurave të kërkuara të cilat kanë shërbyer për vlerësimet dhe vendimmarrjet e respektive të ERE-s, sipas periudhave paraardhëse.

- Në kushtet kur nuk ka dhe një historik të konsumit faktik për kategoritë e reja të propozuara, të ardhurat e realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës, do të shpërndahen sipas kategorive të klientëve bazuar në përqindjet e shitjeve në kwh, në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a. në zbatim të nenit 7, germa "g" të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)".

- Nëse ERE do të konstatojë nevojën e rishikimit të kostove të aktivitetit të FSHU sh.a., si dhe çmimeve të shitjes me pakicë për këto kategori klientësh apo dhe klientët e tjerë, të cilët shërbehen në kushtet e shërbimit univesal të furnizimit në periudhën në vijim, mbështetur në faktorë dhe rrethana domethënëse, të cilat impaktojnë kostot e aktivitetit të shoqërisë, sikurse është vepruar dhe në periudhat e mëparshme rregullatore, ERE do të kryejë rivlerësim dhe rialokimin e tyre në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët "Furra buke/prodhim mielli" të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV sipas kategorive në vijim:

a) Kategoria I – Vetëm furra buke/prodhim mielli, që disponojnë: licenca për prodhim dhe tregtim buke me NIPT të veçantë të dedikuar ose sekondar; ambient i prodhimit ose tregtimit është i veçantë, me dalje më vete dhe i ndarë me ambientet e tjera; këto pajisje janë të domosdoshme; dhomë ardhjeje, brumatriçe me kapacitet mbi 50 kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregtimin e bukës – çmimi i shitjes së energjisë elektrike 7.6 lekë/kwh.

b) Kategoria II – Furrë buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri, që disponojnë: licenca prodhim dhe tregtim buke, brumëra dhe pastiçerie; në ambientet e prodhimit dhe të tregtimit këto pajisje janë të domosdoshme: dhomë ardhjeje, brumatriçe me kapacitet mbi 50 kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregtimin e bukës; në ambientet e saj mund të ketë dhe pajisje të tjera për prodhimin, ruajtjen dhe tregtimin e të gjitha produkteve të veta, të pastiçerisë dhe brumërave, si: Pajisje frigoriferike pune, ngrirës dhe freskues, mikser, abatitor, sfoliatriçe, pajisje të tjera pastiçerie,

banakë (ekspozitor), freskues, ngrirës, ngrohës për tregtimin vetëm të produkteve të veta, të bukës, pastiçerisë dhe brumërave – çmimi i shitjes së energjisë elektrike 9.5 lekë/kwh;

c) Kategoria III – Furrë buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri, shërbim kafe (ekspres) – që disponojnë në ambientet e tyre, që prodhojnë dhe tregtojnë bukë, pastiçeri dhe prodhime brumërash; kanë të instaluar pajisjet përkatëse, si dhomë ardhjeje, brumatriçe me kapacitet mbi 50 kg, pajisje frigoriferike pune, makinë prerëse buke, sistem ndriçimi, ajrosje, kondicionimi, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për prodhimin dhe tregtimin e bukës; në ambientet e subjekteve mund të ketë dhe pajisje të tjera për prodhimin, ruajtjen dhe tregtimin e të gjitha produkteve të veta, të pastiçerisë dhe brumërave, si pajisje frigoriferike pune, ngrirës dhe freskues, mikser, abatitor, sfoliatriçe, pajisje të tjera pastiçerie, banakë (ekspozitor), freskues, ngrirës, ngrohës për tregtimin vetëm të produkteve të veta, të bukës, pastiçerisë dhe brumërave; në këto ambiente mund të përfshihet edhe shërbimi bar-kafe dhe ushqim vetëshërbim – çmimi i shitjes së energjisë elektrike 12 lekë/kwh;

2. Çmimi i energjisë aktive në orar piku do të jetë sipas tabelës bashkëlidhur:

Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive (Lekë/kWh)	**Çmimi i energjisë aktive në orar pik (Lekë/kWh)
Kategoria I - Vetëm Furra Buke/Prodhim mielli	7.6	8.74
Kategoria II - Furrë Buke, produkte mielli shoqëruese, pastiçeri	9.5	10.93
Kategoria III - Furre Buke, Produkte Mielli shoqëruese, Pastiçeri, shërbim Kafe (ekspres)	12	13.80
***Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është:*		
Për periudhën 1 Nëntor- 31 Mars nga ra 18:00-22:00		
Për periudhën 1 Prill-31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

3. Të ardhurat e realizuara mbi/nën ato të lejuara do të korrigjohen nga ERE, në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017, në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a., sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

4. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë shoqërinë FSHU sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe aplikohet për faturimet që kryhen duke filluar nga muaji maj 2024 deri në 31 dhjetor 2024.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi